



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

Fjalimi përshëndetës i Guvernatorit

Janar 31, 2024

Konferenca: Këshilli Kombëtar i Pagesave – takimi rithemelues dhe hapës për vitin 2024

Organizator: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Koha dhe vendi: 31 janar 2024 ora 08:30-15:30, Swiss Diamond Hotel, Prishtinë

I nderuari, z. Murati, Ministër i Financave, Punëve dhe Transfereve

Të nderuar anëtarë të Bordit të BQK-së

Shumë i nderuari, z. Albertine nga USAID në Kosovë

Të nderuar përfaqësues të Zyrës së BE-së, Madsen

Të nderuar përfaqësues nga Ambasada e Zvicrës

Të nderuar përfaqësues të FMN-së dhe Bankës Botërore

Të nderuar përfaqësues të VISA dhe Master Card

Të nderuar drejtues të bankave dhe institucioneve financiare

Përfaqësues të institucioneve qeveritare

Shumë të respektuar të pranishëm

Zonja dhe zotërinj,

Fillimisht më lejoni të ju falënderohem për pjesëmarrjen tuaj në këtë ngjarje të organizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës lidhur me rithelimin e Këshillit Kombëtar të Pagesave në funksion të mbështetjes së reformave në fushën e pagesave përmes zgjerimit të përfshirjes dhe rritjes së bashkëpunimit ndërmjet akterëve të tregut në sistemin e pagesave në Republikën e Kosovës.

Ashtu sikurse jeni informuar, kjo ngjarje ka për qëllim:

- Riorganizimin dhe funksionalizimin e Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP), përkatësisht, zgjerimin e anëtarësisë së KKP-së si një organ këshillimor në mbështetje të reformave në fushën e pagesave dhe rritjes së sigurisë së Sistemit Kombëtar të Pagesave;
- Përditësimin mbi zhvillimet e infrastrukturës ligjore dhe teknike në fushën e pagesave sikurse janë zhvillimet në proceset dhe planet për avancimin e kuadrit ligjor dhe infrastrukturës teknike të sistemit dhe shërbimeve të pagesave; dhe

- Përcaktimin e një plani kombëtar për përfshirjen financiare dhe reduktimin e përdorimit të parave të gatshme ku aktivitetet e palëve të interesuara do të përcaktohen dhe dakordohen për rritjen e qasjes, përdorimit të llogarive të pagesave dhe instrumenteve të pagesave elektronike dhe reduktimin e parasë së gatshme, me qëllim uljen e kostos së shërbimeve të pagesave për rrjedhën më efikase të transaksioneve si dhe efekteve të tjera pozitive në ekonomi.

Në këtë dinamikë të zhvillimit botëror edhe sistemi jonë financiar është duke u ballafaquar me një ndryshim të shpejtë në fushën e inovacionit dhe migrimit drejt pagesave digjitale.

Një sistem i shëndoshë dhe efikas i pagesave mbështetë zhvillimin e mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar dhe rritjen e stabilitetit financiar duke krijuar kështu një klimë në të cilën investitorët mund të zgjerojnë bizneset e tyre. Një sistem i zhvilluar financiar i pagesave ku pagesat realizohen me kosto të arsyeshme dhe me efikasitet në kohë e bëjnë tregtinë më të lirë dhe mundësojnë që bizneset konkurruese të rriten dhe t'u ofrojnë konsumatorëve qasje më të lehtë në mallra dhe shërbime.

Njëkohësisht, një Sistem i zhvilluar i Pagesave siguron mbrojtjen e integritetit të sistemit financiar dhe të valutës euro, zvogëlimin e efekteve negative nga dukuria e falsifikimit të parave, mbrojtjen e konsumatorit dhe avancimin e praktikave të tregut, zvogëlimin e efekteve nga aktivitetet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, qasjen e shtuar në shërbimet financiare dhe gjithëpërfshirjen financiare.

Në linjë me Marrëveshjen për Stabilizim- Asociim dhe Procesin e Berlinit, procesi i reformave dhe avancimi i Sistemit të Pagesave përmes Zhvillimit të Pagesave të shpejta lokale dhe integrimi i sistemit të pagesave në nivel të rajonit do të përshpejtojnë edhe qasjen në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro të Bashkimit Evropian e njohur si SEPA. Kjo ka për detyrë të sjellë në mënyrë efektive pagesat e brendshme dhe ndërkufitare brenda BE-së në të njëjtin nivel të kostos, efikasitetit në kohë dhe sigurisë si dhe qasjen në Sistemin e Pagesave të Shpejta të BE-së të njohur si TIPS që është pjesë e Eurosistemit nga viti 2018. Kjo u mundëson ofruesve të shërbimeve të pagesave të ofrojnë transfere të fondeve për klientët e tyre në kohë reale dhe gjatë gjithë kohës, çdo ditë të vitit, pra, ku individët dhe bizneset mund të transferojnë para ndërmjet njëri-tjetrit brenda disa sekondave, pavarësisht nga ora e punës së bankës së tyre lokale. Edhe vet rregullorja e fundit për operacionet me para të gatshme, shënon një avancim shumë të madh në aspekt të përafrimit me kërkesat dhe standardet për anëtarësim në SEPA, si dhe TIPS.

Pra, BQK ka nisur ndërmarrjen e veprimeve në kuadër të Planit Strategjik 2024-2028 për aktivitetet të cilat janë planifikuar dhe që lidhen me fushën e sistemit të pagesave janë si në vijim:

- Avancimi i infrastrukturës ligjore dhe teknike të BQK-së për anëtarësim në Skemën e Pagesave SEPA dhe qasje në Sistemin e Pagesave të Shpejta të BE (TIPS);
- Zhvillimi i infrastrukturës teknike për mundësimin e pagesave të shpejta 24/7, krijimi i QR Kodit kombëtar dhe standardizimi i API-së për ndërlidhje të sistemeve;
- Reduktimi i pagesave me para të gatshme si dhe promovimi i pagesave elektronike;

Kurse për dy nga aktivitetet e mëposhtme kemi tashmë zhvillime, si:

- Krijimi i mundësive për qasjen në sistemin e pagesave të ofruesve të shërbimeve jobankare, si dhe mundësimi i posedimit të IBAN-it, për të rritur qasjen në financa, në kuadër të konceptit të "llogarisë për pagesa", ku kemi miratuar rregulloren,

Si dhe sot, po realizojmë aktivitetin e paraparë:

- Fuqizimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave si organ këshillues për veprime të përbashkëta rreth digjitalizimit dhe standardizimit të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave;

Avancimi i Sistemit të Pagesave paraqet sfida të konsiderueshme si nga perspektiva e BQK-së ashtu edhe nga ajo bankave dhe institucioneve financiare jobankare dhe kërkon bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë.

Por, më lejoni të njoftoj edhe për disa aktivitete që BQK ka ndërmarrë në funksion të zhvillimit të Sistemit të Pagesave:

- Pjesëmarrja në takime të nivelit të lartë në Bankën Qendrore Evropiane (BQE) në Frankfurt, me guvernatorët dhe zëvendësguvernatorët e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, lidhur me integrimin në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore, përkatësisht në skemën e pagesave SEPA dhe sistemin e pagesave të shpejta TIPS, ku BQE-ja në kuadër të mbështetjes së projektit të BE-së për Modernizimin e Sistemeve të pagesave të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe objektivave të G20-së, mbështetë nisma konkrete siç është ajo e ndërlidhjes së sistemeve të pagesave dhe përfshirjes së rajonit tonë në sistemet e Bashkimit Evropian dhe është në kontakt të vazhdueshëm për zhvillimet e mëtejshme.
- Ka ndryshuar Strukturën Organizative ku përveç Divizionit të Analizave dhe Mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave, Divizionit të Mbikëqyrjes së IMF /IFJB i është shtuar edhe përgjegjësia e mbikëqyrjes së IP dhe IPE, është themeluar Divizioni i Mbikëqyrjes së Sistemeve të TI-së, në kuadër të Divizionit të Regjistrimit të Kredive është shtuar edhe përgjegjësia e Regjistrimit të Llogarive Bankare, si dhe është themeluar Departamenti i Mbrojtjes së Konsumatorit ku përveç Divizionit të Ankesave të Konsumatorëve të Shërbimeve Financiare është themeluar edhe Divizioni i Mbikëqyrjes së Praktikave të Tregut.
- Ka proceduar më tutje me Draft-ligjin për Bankat, i cili tashmë është në konsultime publike, i cili bashkë edhe me ligjet tjera, do të përmbyll në mënyrë komplementare ekosistemin financiar,
- Është në proces të finalizimit të draft-ligjit për shërbimet e pagesave, në pajtueshmëri me Direktivat e BE-së sikurse janë PSD2 (Payment Services Directive 2), EMD (E-money Directive), PAD (Payment Account Directive), dhe Interchange Fees.
- Është në proces të ngritjes së kapaciteteve infrastrukturore dhe burimeve njerëzore për të siguruar që sistemet, pajisjet, njohuritë, aftësitë dhe mjetet e personelit të mbeten relevante dhe efektive në mbikëqyrjen e rrezeve të teknologjive të reja dhe modeleve inovative të biznesit.

Gjithashtu institucionet financiare të licencuara nga BQK, në funksion të avancimit të sistemit të pagesave dhe ngritjes së cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të pagesave për klientët e tyre, inkurajohen që:

- Të investojnë në infrastrukturë dhe ngritin kapacitetet njerëzore;
- Të avancojnë politikat, procedurat dhe proceset e menaxhimit të rreziqeve;
- Të adresojnë rreziqet kibernetike përmes bashkëpunimit të ngushtë me BQK-në dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse për sigurinë kibernetike në nivel shtetëror.

Edukimi financiar do të jetë në fokusin e BQK-së, krahas avancimit të praktikave të tregut dhe mbrojtjes së konsumatorëve. Prandaj, do të organizohen dhe mbështetën kampanja për edukimin financiar të përdoruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me përfitimet, mënyrën e realizimit, sigurinë dhe rëndësinë e pagesave digjitale/elektronike.

Zgjerimi i infrastrukturës fizike dhe harduerike, zgjerimi i qasjes në financa dhe gjithpërfshirja, gjithashtu synohet të arrihet përmes këtij mekanizmit të sotëm, që gradualisht na vendos në rrugën drejt një ekonomie me sa më pak para të gatshme (cash), dhe një sistemi të integruar të pagesave të shpejta, 24/7. Për këtë, kërkohet angazhim dhe koordinim nga të gjithë, ndaj edhe njëherë Ju faleminderit të gjithëve për prezencën dhe kontributin tuaj institucional e personal.

Me këtë rast, shfrytëzoj rastin të falënderoj për bashkëpunimin dhe bashkërendimin me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe për asistencat teknike të dhënë BQK-së ndër vite, partnerët ndërkombëtar si FMN dhe Bankën Botërore, që viteve të fundit na ka mbështetur përmes Programit të Pagesave dhe Remitancave të financuar nga SECO dhe Projektit për Modernizimin e Sistemit të Pagesave të vendeve të Ballkanit Perëndimor nën administrim të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) dhe të financuar nga Bashkimi Evropian.

Gjithashtu, më lejoni që të falënderoj Qeverinë Amerikane dhe institucionet e saj, me theks Thesarin Amerikan dhe USAID-in për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë BQK-së në ngritjen e kapaciteteve për fusha të ndryshme që lidhen me mandatin e BQK-së dhe sidomos për projektet që i kemi në proces lidhur fushën e qasjes në financa dhe zhvillimin e tregut të kapitalit.

Më lejoni të përfundoj këtu duke ritheksuar se avancimi i sistemit kombëtar përmes mundësisë të pagesave "instant" (24/7), si dhe ndërlidhja me sistemin TIPS si objektiv i BQK-së, kur të arrihet do të ketë ndikim të madh në ekonominë e vendit tonë, rajonit, diasporës, si dhe qarkullimin e pagesave për shkëmbimet tregtare me BE-në, si partneri më i madh tregtar i Republikës së Kosovës me një rëndësi për lëvizjen e lirë të kapitalit, shërbimeve dhe produkteve, përfshirë lëvizjen e lirë të njerëzve nga Kosova përmes liberalizimit të vizave nga 1 janari i këtij viti.

Duke qenë se KKP tashmë është zgjeruar, dhe ka një përbërje që reflekton edhe sistemin financiar dhe ekonominë në tërësi, konsideroj se kemi një mundësi që të koordinojmë qasjen dhe politikat për të arritur një zhvillim që në mënyrë substanciale ndërron situatën, na sjell në një nivel të ri, dhe shumë më afër me objektivin tonë të përafrimit me Bashkimin Evropian.

Ju uroj punë të mbarë dhe diskutime të frytshme!